Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna e Istogut
Opshtina Istok
Municipality of Istog

01 Numër: 80/2015
Data: 28.09.2015

http://kk.rks-gov.net/istog/

Rregullorja Komunale Nr. 6/2015

KUVENDI I KOMUNËS ISTOG

RREGULLORE
PËR VENDOSJEN E TATIMIT NË PRONË E PALUAJTSHME

Istog, Shtator 2015

Kuvendi i Komunës Istogut, bazuar në nenin 12.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr.03/L-204(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me nr. 88), plotësim ndryshimi i Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr.04/L-100(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me nr.14/2012), Udhëzimit Administrativ Nr.03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin dhe nenit, 33 paragrafi 1. të Statutit të Komunës Istogut, 01 Nr.62/2010, në mbledhjen e mbajtur me: 28.09.2015, miratoi këtë :

RREGULLOREN
PËR VENDOSJEN E TATIMIT NË PRONËN E PALUAJTSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është që të vendoset tatimi mbi pronat e paluajtshme në Komunën e Istogut. Rregullorja mundëson identifikimin, regjistrimin dhe vlerësimin e pronave të cilat do t'i nënshtrohen tatimit në pronë, i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën e përcaktuar me Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme sipas vlerës së pronës në treg dhe përgjegjësit komunale në administrimin e tatimit mbi pronën që është nenë juridiksionin e saj.

Neni 2

Baza e tatimit për tatimin mbi pronën do të jetë vlera e pronës në treg.
Për çdo vit tatimor vlerë e tregut e cilësdo pronë është vlera e pronës deri më 31 dhjetor të vitit paraprak, bazuar në kontrata të shitblerjeve, hipotekave, informatave lidhur me qiratë dhe vlerësimet nga ekspertet për vlerësim.

Neni 3

1. Vendndodhja e pasurisë ndikon dukshëm në vlerën e saj, varësisht nga vendndodhja janë krijuar 4 zona të vlerësimit që paraqesin ndryshimet në vlerën e pasurisë.
2. Zona e parë përfshinë të gjitha objektet që gjinden në qendrën e qytetit të Istogut duke filluar nga qendra dhe përfundojnë në përfundim të rrugëve "Dëshmoret Dervishaj", " UÇK", "Femi Agani "Bajram Gashi","20 Qërshori".
3. Zona e dytë është zonë e urbanizuar përfshinë të gjitha objektet të cilat janë jashtë zonës së parë të qytetit të Istogut, objektet në rrugën"Smail Bicaj", objektet në fshatin Istog i Poshtëm, objektet që fillojnë me rrugën "Hysen Bujupi" përfundojnë më rrugën" Rudina" dhe rrugën "Qameria", si dhe objektet në qendrat urbane: Banjë, Gurrakoc dhe Vrellë.
4. Zona e tretë përfshinë objektet në të gjitha fshatrat e Komunës së Istogut përveç fshatrave të zonës rurale.

5. Zona e katërt përfshinë objektet në fshatrat rurale të Komunës së Istogut të cilat janë: Mojstiri, Shushica, Cerkolezi, Suhogërlla, Zhakova, Shalinovica, Koshi, Tuçepi, pjesa e lartë e Studenicës, Kaliqanit dhe Uçës.

Neni 4
Shkallët e tatimore

Shkalla e tatimit në pronën e paluajtshme, në pajtim me nenin 7. paragrafi 1 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme me Nr. 04/L-100, Kuvendi Komunal i cakton tarifat tatimore mbin pronën në bazë vjetore në shkallën tatimore si vijon :

Kategotit e pronës	Shkalla e tatimit
1. Pronat Rezidenciale-shtëpi, banesa	0.15 %
2. Garazhet	0.15 %
3. Pronat e pa përfunduara	0.15 %
4. Pronat Bujqësore	0.15 %
5. Hurdhat e peshqve	0.15 %
6. Pronat Komerciale	0.20 %
7. Fusha e sportit e mbuluar, pishina, mbuloja e pompës benzenit	0.20 %
8. Pronat Industriale	0.20 %
9. Depo-magazinë	0.20 %

Neni 5
Kategoritë e pronës sipas zonave të shkallës tatimore dhe vlerës së tregut në € për m².

	0.15/%			0.20%		0.20%	015%	0.15%	0.15%
Zona	Shtëpi banimi	Apartament Banesë	Garazhe	Prona komerciale	Prona industriale	Pishina Fushë Sporti Mbuloja Pompës së benzinës	Prona Bujqësore	Hurdhat e peshqve	Pronat e pa Përfunduara 40%
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
I	250	300	150	600	450	100	100	200	250
II	200	250	120	500	400	80	80	160	200
III	180	180	100	400	350	60	60	120	180
IV	150	150	80	300	300	40	40	80	150

Objektet e kryera deri në përfundimin e pullazit (kulmit), ngarkohen me tatim me 40% të vlerës që ka një objekt banimi duke u bazuar në nenin 7 paragrafi 2.7 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme.

Neni 6
Zbritja lidhur me vendbanimin kryesor

2. Zbritja lidhur me vendbanimin kryesor lejohet në shumë prej 10.000 euro nga vlera e tatueshme e pronës, e definuar në nenin 9 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme.

Neni 7
Llogaritja e tatimit për objekte komerciale që nuk zhvillojnë afarizëm

Të gjitha objektet komerciale të cilat nuk zhvillojnë afarizëm tatimohet me 70% të vlerës së tregut, bazuar në nenin 17 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ Nr.3/2011

Neni 8.
Lirimi nga tatimi mbi pronën e paluajtshme

Pronat të cilat lirohen nga Tatimi në pronë, sipas nenin 8, të Ligjit për Tatim në Pronën e Paluajtshëm lirohen edhe në Komunën e Istogut.

Neni 9
Shtyrja e tatimit

Shtyrja e pagesës së Tatimit në Pronë në rrethana të posaçme mund të bëhen bazuar në nenin 16 të Ligjit për Tatimin në Pronë e paluajtshme.

Neni 10
Vlerësimi i pronës

Vlerësimi i pronës bëhet sipas vlerës së tregut në pajtim me standardet e vendosura nga Ministria e Financave bazuar në nenin 13 të Ligjit për Tatimin në Pronë e paluajtshme.

Neni 11
Përgjegjësit komunale

Në pajtim me nenin 11, paragrafi 1.4 të Ligjit për Tatimin në Pronën e paluajtshme, Kryetari i Komunës emëron Bordin Komunal për ankesa bazuar në Përgjegjësit Komunale i cili do të merret me shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve.

Neni 12

Të gjitha çështjet tjera që kanë të bëjnë me tatimin në pronë e që nuk janë të përfshirë në këtë Rregullore, i rregullojnë Ligjet për tatimin në pronën e paluajtshme me Nr. Ligjit Nr.03/L-204, Plotësim ndryshimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr.04/L-100 dhe Udhëzimet Administrative.

Neni 13

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për vendosjen e tatimit në pronën paluajtshme me Nr.4/2014.

Neni 14

Rregullorja hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

KRYESUESI I KUVENDIT
Hazbi Bajra